



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E GJILANIT

OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

Numri i lëndës: 2020:141410

Datë: 20.11.2020

Numri i dokumentit: 01288782

P.nr.856/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Sabedin Mushica, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Blerina Hyseni, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. A, nga Gjilani, për shkak të veprës penale, mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës(KPRK-së)¹, të cilin e mbron sipas detyrës zyrtare avokatja Albesjana Rexhepi-Uka nga Gjilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilane-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.1746/2020, të datës 02.11.2020, pas mbajtjes së seancës dëgjimore në lidhje me pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datë 06.11.2020, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. A., nga babai R., nëna F., i lindur me datë ..., në Gjilane, ku edhe jeton,(afër postës së vogël), i martuar, baba i katër fëmijëve, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të përfunduar shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe Maqedonisë.

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr.04/L-082, i datës 20 prill 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 07.11.2017, në kohë të pavërtetuar, në Gjilan, me anë të paraqitjes së rreme të fakteve, e me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, në mënyrë mashtruese e vë në lajthim të dëmtuarin I. J, nga në atë mënyrë që pasi takohen në një i akuzuari e mashtron të dëmtuarin duke i thënë : nëse mi jep 4.000 euro, brenda 4 ose 5 muajve, do ta rregulloj një pasaportë të shtetit maqedonas me nënshtetësi të Maqedonisë, me ç'rast i dëmtuari mashtrohet dhe herën e parë i'a jep 1.000 euro, herën e dytë 250 euro, herën e tretë 500 euro, dhe herën e katërt 250 euro, dhe nuk i është përgjigjur as një herë të dëmtuarit dhe në këtë mënyrë tani të dëmtuarit Isa Jakupi, i shkakton dëm në vlerë prej 2.000 euro.

-Me çka ka kryer veprën penale, mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51,52, 73, 74 dhe 75 të KPRK-ës, nenit 233 lidhur me nenin 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP)², të akuzuarin e lartcekur:

E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 600€(gjashtëqind)euro, të cilin gjobë do ta paguajë në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180(njëqindë e tetëdhjetë)ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën e verifikimit prej 1(një) viti nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale.

Nëse i akuzuari i lartcekur nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që cakton 1 (një) ditë burgim për çdo 20 € (njëzetë) Euro, të dënimit me gjobë.

Në rast të revokimit të dënimit me kusht, koha e kaluar në paraburgim edhe atë nga data 21.10.2020 e deri më 06.11.2020, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Masa e paraburgimit e caktuar me aktvendimin e kësaj gjykate PPr.nr.191/2020 i datës 23.10.2020, i ndërprehet me datë 06.11.2020.

Obligohet i akuzuari i lartcekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 30€(tridhjetë)euro si dhe shumën prej 30€(tridhjetë)euro në emër të kompensimit për viktimat e krimit, në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 03.11.2020, ka dorëzuar në këtë gjykatë aktakuzën me numër PP.II.nr.1746/2020, të datës 02.11.2020, kundër

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13 dhjetor 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

të akuzuarit B. A., nga Gjilani, për shkak të veprës penale, Mashtrimi nga neni 323 paragrafi 1 të KPRK-ës, ku së bashku me aktakuzë ka dorëzuar edhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të datës 02.11.2020, të arritur mes Prokurorisë Themelore në Gjilan në njërën anë dhe të akuzuarit B. A., me mbrojtësen e tij, në anën tjetër, sipas të cilës marrëveshje kësaj gjykate i është rekomanduar edhe lloji dhe lartësia e sanksionit penal.

Gjykata me datë 06.11.2020, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore lidhur me marrëveshjen e pranimit të fajësisë, ku kanë prezantuar, prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, i dëmtuari I. J³, i akuzuari B. A me mbrojtësen e tij avokate Albesiana Rexhepi-Uka, edhe i kanë propozuar gjykatës që marrëveshjen për pranimin e fajësisë ta aprovojë.

2.Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Gjykata, pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në bazë të nenit 233 të KPP-ës. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë e arritur mes Prokurorisë Themelore në Gjilan si dhe të akuzuarin B. A me mbrojtësin e saj avokate Albesiana Rexhepi-Uka, i përmbush të gjitha kushtet ligjore si dhe e njëjta është arritur në bazë të nenit 233 të KPP-ës, po ashtu gjykata ka konstatuar faktin se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë si dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara nga neni 253 paragrafi 1 e 2 të KPP-ës.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykataëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i akuzuari B. A, ka kryer veprën penale, Mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 të KPRK-ës, si në vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73 dhe 74 të KPRK-së, në këtë aspekt si rrethanë veçanërisht lehtësuese e ka marrë për bazë se i njëjti ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë, është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale, ka shprehur keqardhje për veprimime bërë, e ka bërë kompenimsin e dëmit. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, motivin për kryerjen e kësaj vepre penale, rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale.

5.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit të lartcekur, duke i marr parasysh rrethanat lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë të akuzuarit. Gjykata, po

³ Nuk e ka kundërshtuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe ka deklaruar se nuk do të paraqet kërkesë pasurore juridike për shkak se shumë prej 2000€(dy mijë)Euro, ia kanë kompensuar familja e të akuzuarit.

ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6.Llogaritje e paraburgimit në dënimin e shqiptuar

Në 83 paragrafi 1 të KPRK-ës parashihet se “*Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim dhe me gjobë*”, andaj në rastin konkret i akuzuari i lartcekur, ka qëndruar nën masën e paraburgimit edhe atë nga data 21.10.2020 deri më datë 06.11.2020, dhe në rast se revokohet dënimin me burgim me kusht, i njejtë do të llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

7.Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Duke u bazuar në nenin 46 paragrafi 3 të KPRK-së nëse i akuzuari refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimin me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do të caktohet një ditë burgim efektiv.

8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarit gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të akuzuarin ta obligojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 30€, si dhe shumën prej 30€, për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

P.nr.856/2020

Me datë 06 Nëntor 2020

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Sabedin Mushica

KËSHILLA JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.